



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2021:268432

Datë: 13.05.2024

Numri i dokumentit: 05697455

Ac.nr.7778/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË, në kolegjin e përberë nga gjyqtarët Hysni Bardheci, kryetar i kolegjit, Bujar Muzaqi dhe Enes Mehmeti, anëtarë të kolegjit, me pjesëmarrjen e bashkëpunëtores profesionale Robertina Lekaj, në çështjen juridike kontestimore të paditësit D.V., nga Mitrovica, të cilin sipas autorizimit e përfaqëson F.Sh., avokat në Mitrovicë, kundër të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme–Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, të cilën e përfaqëson Avokatura Shtetërore në Ministrinë e Drejtësisë të Republikës së Kosovës, me objekt kontesti kompensim në emër të pagës së 13-të dhe shujtave, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, të parashtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1753/2021, të datës 04.10.2022, në seancën e kolegjit të mbajtur më datë 30.04.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET e pathemeltë ankesa e të paditurës Ministria e Punëve të Brendshme–Policia e Kosovës, me seli në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1753/2021, i datës 04.10.2022, në pikën I dhe III të dispozitivit **VËRTETOHET**.

II. Pika II e dispozitivit të aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, C.nr.1753/2021, të datës 04.10.2022, mbetet e pa shqyrtuar.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Mitrovicë-Departamenti i Përgjithshëm, me aktgjykimin e atakuar C.nr.1753/2021, të datës 04.10.2022, ka vendosur si në vijim: “I. Aprovohet pjesërisht si e bazuar kërkesëpadia e paditësit D.V. ashtu që detyrohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që në emër të kompensimit të pagës së fund vitit dhe atë për vitet 2018, 2019 dhe 2020, t’ia paguaj paditësit shumën prej 1,715.75 euro, të gjitha me kamatë ligjore 8%, duke

e llogaritur nga data 30.11.2021, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. II. Refuzohet si e pabazuar pjesa tjetër e kërkesëpadisë së paditësit, me të cilën ka kërkuar që të obligohet e paditura Ministria e Punëve të Brendshme-Policia e Kosovës, që në emër të kompensimit të pagës së fund vitit për vitin 2021 në lartësi prej 571.90 euro dhe në emër të kompensimit të shujtës ushqimore, me kamatë ligjore 8%, duke e llogaritur nga data 30.11.2021, datë e paraqitjes së padisë në gjykatë, e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh, nga dita e marrjes së këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm. III. Detyrohet e paditura, që paditësit t'ia kompensoj shpenzimet e procedurës kontestimore në shumë prej 269 euro, në afat prej 7 ditësh, nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënim të përmbarimit të detyrueshëm”.

Kundër këtij aktgjykimi brenda afatit ligjor, ankesë ka paraqitur pala e paditur, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës kontestimore, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike si dhe zbatimit të gabuar të së drejtës materiale, me propozim që Gjykata e Apelit ta aprovojë në tërësi si të bazuar ankesën e të paditurës, ta prish aktgjykimin C.nr.1753/2021 të datës 04.10.2022, në pikën I dhe III, si dhe të refuzojë padinë dhe kërkesëpadinë e paditësit si të pabazuar.

Përgjigje në ankesë ka paraqitur i autorizuari i paditësit duke i kundërshtuar pretendimet ankimore, me propozim që ankesa e të paditurës të refuzohet në tërësi si e pabazuar dhe të vërtetohet aktgjykimi i atakuar C.nr.1753/2021.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194 dhe 195 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa e të paditurës është e pathemeltë.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se paditësi, përmes përfaqësuesit të autorizuar, me datën 30.11.2021 ka ushtuar padi kundër të paditurës për kompensimin e pagës së trembëdhjetë dhe shujtave, të precizuar në seancën e datës 22.09.2022. E paditura, me përgjigje në padi e ka kundërshtuar padinë e paditësit duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pabazuar.

Gjykata e shkallës së parë duke vepruar sipas padisë së paditësit, pas shqyrtimit dhe administrimit të provave pas shqyrtimit kryesor të çështjes ka nxjerrë aktgjykimin e atakuar C.nr.1753/2021 të datës 04.10.2022, me të cilin e ka aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit, duke vendosur më decidivisht si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar.

Në arsyetim të aktgjykimit të atakuar, gjykata e shkallës së parë ka konstatuar se në mes të palëve ndërgjyqësve nuk ishte kontestuese se paditësi është në marrëdhënie pune tek e paditura, megjithatë gjykata këtë e vërtetoi edhe nga vërtetimi i punësimit i datës 26.04.2021 i cili gjendet i bashkangjitur shkresave të lëndës dhe është i lëshuar nga e paditura për paditësin, nga i cili vërtetim gjykata konstatoi se paditësi tek e paditura realizon pagë mujore në shumë prej 571.90

€, këto arsye gjykata ka vendosur që pjesërisht të aprovojë kërkesëpadinë dhe të obligojë të paditurën që paditësit t'ia kompensojë shumat e përshkruara si në pikën I të dispozitivit të aktgjykimit të ankimuar duke u bazuar në nenin 29, paragrafi 2 të Udhëzimit Administrativ nr.02/2018. Vendimin për kamatëvonesë, gjykata e ka marrë në kuptim të nenit 382, paragrafi 2 të LMD-së, ashtu që e njëjta do të llogaritet nga dita e paraqitjes së padisë e deri në pagesën definitive. Sa i përket shpenzimeve të procedurës, gjykata ka arsyetuar se ka vendosur konform dispozitave të nenit 452, paragrafi 1 të LPK-së.

Gjykata e Apelit nisur nga kjo gjendje e çështjes vlerëson së qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm, pasi që aktgjykimi i atakuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi 2, pika b), g), j), k) dhe m) e LPK-së, dhe e drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë, për të cilat shkaqe Gjykata e Apelit kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së, e po ashtu nuk është i përfshirë as në shkelje tjera të dispozitave të procedurës kontestimore, të cilat i ka pretenduar pala ankuese.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës për shkelje të dispozitave të procedurës kontestimore, pasi që me rastin e hartimit të aktgjykimit, gjykata e shkallës së parë ka dhënë arsye të mjaftueshme për mënyrën e vendosjes në këtë çështje juridike kontestimore, duke arsyetuar të gjitha faktet vendimtare të cilat kanë ndikuar që e njëjta të vendos si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, të cilat arsye janë të pranueshme edhe për gjykatën e shkallës së dytë. Dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është mjaft i qartë, e në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Po ashtu, gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe faktet vendimtare si marrëdhënia e punës dhe prezenca e paditësit në punë tek e paditura, përkatësisht në institucionin ku punon dhe lartësia e pagës bazë të tij.

Nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale, për arsyeje se baza juridike e kërkesëpadisë së paditësit për kompensimin e pagës së trembëdhjetë është e rregulluar me dispozita të Ligjit për Policinë Nr.04/L-076, si dhe nenet 44 dhe 45 dhe Udhëzimit Administrativ nr.02/2018 mbi marrëdhënien e punës në Policinë e Kosovës, konkretisht të nenit 29, par.2 i cili përcakton të drejtën për pagën e 13-të kur kemi të bëjmë me vlerësim të kënaqshëm, në të cilin nen shprehimisht parashihet që: *“Personelit të Policisë të cilët kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës, do të përfitojnë si shpërblim një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore ne fund te vitit”*. Duke u bazuar në këto dispozita materiale të cilat përcaktojnë këto të drejta dhe detyrime për palët ndërgjygjëse dhe gjendjen faktike të vërtetuar, gjykata e shkallës së parë drejtë ka konstatuar faktin se paditësi është aktualisht në marrëdhënie pune tek e paditura, për çka edhe drejtë ka vendosur si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, duke e aprovuar pjesërisht si të bazuar kërkesëpadinë e paditësit dhe duke e detyruar të paditurën që paditësit t'ia shpërblejë (kompensojë) 3 (tri) paga mujore në emër të pagës së 13-të, në shumën prej 1,715.70 €, për vitet 2018, 2019 dhe 2020 mbi bazën e vlerësimit të performancës, të provuara përmes provave materiale të cilat gjenden në shkresat e lëndës.

Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, personeli i policisë ka të drejtë në shpërblimin e një page mujore ekuivalente me pagën e rregullt mujore në fund të vitit, për vitin 2018, 2019 dhe 2020, nëse plotësohen këto kushte dhe atë: që personeli i policisë që kanë marrë vlerësim të kënaqshëm dhe të cilët nuk kanë qenë subjekt i shqiptimit të ndonjë mase disiplinore brenda vitit përkatës bazuar në Udhëzimin Administrativ me numër 02/2018, i cili ka hyrë në fuqi me datë 14.11.2018, ndërsa është i papranueshëm çdo arsytim eventual për mungesë të mjeteve buxhetore. Kjo çështje është sqaruar edhe përmes Mendimit Juridik të Gjykatës Supreme të Kosovës me numër 213/2023 e datës 09.10.2023, ku përcaktohet e drejta e personelit të policisë në kompensimin e pagës së trembëdhjetë me plotësimin e kushteve ligjore si më lartë.

E drejta materiale është zbatuar në mënyrë të drejtë edhe sa i përket kërkesës aksesore përkitazi me kamatën konform nenit 382 të LMD-së, ndërsa vendimi për shpenzimet e procedurës është në përputhje me dispozitat e nenit e 452 të LPK-së, dhe sa i përket lartësisë është në harmoni me tarifën e Odës së Avokatëve dhe tarifatat për shpenzime gjyqësore.

Gjykata e Apelit vendosi si në pikën II, të dispozitivit të këtij aktgjykimi, meqë aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur me ankesë në pikën II të dispozitivit të tij nga pala me interes juridik andaj, duke iu përmbajtur kufizimit ligjor të mjetit juridik (kufijtë e ekzaminimit të aktgjykimit të ankimuar), sipas nenit 194 të LPK-së, këtë pikë të aktgjykimit të ankimuar nuk e shqyrtoi fare.

Gjykata e Apelit me rastin e vendosjes i vlerësoi edhe të gjitha pretendimet e tjera ankimore, mirëpo të njëjtat nuk ishin me ndikim për një vendim ndryshe për çka edhe vendosi si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Nga të lartcekurat, e në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 paragrafi 1 pika d), lidhur me nenin 200 të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.7778/2022, datë 30.04.2024

Kryetar i Kolegjit-Gjyqtari
Hysni Bardheci